



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 4

Tiranë – E premte, 10 janar 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Udhëzim i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 10, datë 23.12.2024	Për zhvillimin e praktikave të mira bazuar në <i>Toolbox</i> -in e përbashkët të Bashkimit Evropian “Për reduktimin e kostove të aplikimit për rrjetet me kapacitet shumë të lartë dhe mjedisin miqësor të investimeve për rrjetet 5G.....	367
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1131, datë 27.12.2024	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave në kafshët e gjalla të llojit derra të butë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla...	371
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1132, datë 28.12.2024	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	371
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1136, datë 30.12.2024	Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së influencës aviare në shpendë, në mjediset e hapura dhe në tregjet e kafshëve të gjalla.....	372
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 265, datë 10.12.2024	Mbi miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregullat e tregut të energjisë elektrike, të miratuara me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 347, datë 27.12.2022, i ndryshuar.....	373
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 266, datë 10.12.2024	Mbi miratimin e datës së fillimit të tregimit për tregun e ankandeve brenda së njëjtës ditë në Bursën Shqiptare të Energjisë Elektrike.....	406
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 267, datë 10.12.2024	Mbi afatin e nominimit në tregun e balancimit.....	407
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 268, datë 10.12.2024	Mbi licencimin e shoqërisë “Volton” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike	409
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 269, datë 10.12.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.....	410

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 270, datë 10.12.2024	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “ <i>Sunny Side Energy</i> ” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.....	411
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 271, datë 10.12.2024	Mbi kërkesën e shoqërisë “En.Ku” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj.....	412
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 272, datë 10.12.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 179, datë 8.11.2017, “Mbi certifikimin e shoqërisë ‘Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror’ ‘Albgaz’ sh.a.”, i ndryshuar.....	413
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 273, datë 13.12.2024	Mbi miratimin e çmimit të blerjes së energjisë elektrike që do t’u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi për vitin 2025.....	414
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 274, datë 13.12.2024	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin nëntor 2024, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.....	416
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 275, datë 13.12.2024	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 206, datë 7.10.2024.....	417



UDHËZIM

Nr. 10, datë 23.12.2024

PËR ZHVILLIMIN E PRAKTIKAVE TË MIRA BAZUAR NË TOOLBOX-IN E PËRBASHKËT TË BASHKIMIT EVROPIAN “PËR REDUKTIMIN E KOSTOVE TË APLIKIMIT PËR RRJETET ME KAPACITET SHUMË TË LARTË DHE MJEDISIN MIQËSOR TË INVESTIMEVE PËR RRJETET 5G”¹

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 9, të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, si dhe vendimit nr. 434, datë 3.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Infrastrukturës Digjitale, *Broadband*, 2020–2025”,

UDHËZOJ:

Neni 1

Qëllimi

1. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i masave për zhvillimin e praktikave të mira, bazuar në *Toolbox*-in e Bashkimit Evropian, “Për nxitjen e ndërlikohjes në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe rimëkëmbjes ekonomike pas COVID-19”, duke synuar në veçanti:

a) zvogëlimin e kostove dhe rritjen e shpejtësisë së vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike, në veçanti të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, duke përmirësuar procedurat e dhënies së lejeve për punimet civile, duke përmirësuar transparencën dhe duke përforcuar aftësitë e pikave të vetme të informacionit të përcaktuara në ligjin nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, duke

b) mundësuar aksesin në infrastrukturën fizike ekzistuese të kontrolluar nga sektori publik;

¹ Ky udhëzim është i harmonizuar pjesërisht me rekomandimin e Komisionit (BE) 2020/1307, të datës 18 shtator 2020, “Mbi një *Toolbox* të përbashkët të Bashkimit për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe sigurimin e aksesit

c) identifikimin e masave që do të ndihmonin në reduktimin e ndikimit mjedisor të rrjeteve të komunikimeve elektronike;

d) të nxisë aty ku është e mundur dhënien në kohë në përdorim të spektrit të frekuencave dhe duke mundësuar investimet në rrjetet 5G përmes iniciativave proinvestimi;

e) të rrisë koordinimin ndërinstitucional për spektrin, si dhe koordinimet ndërkuftare për ofrimin e shërbimeve inovative 5G.

Neni 2

Përkufizimet

1. Për qëllime të këtij udhëzimi, zbatohen përkufizimet e përcaktuara në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “*Toolbox*-i i BE-së” janë rregullat e miratuara sipas rekomandimit (BE) 2020/1307, të datës 18 shtator 2020, “Mbi një *Toolbox* të përbashkët të Bashkimit për reduktimin e kostos së vendosjes së rrjeteve me kapacitet shumë të lartë dhe sigurimin e aksesit në kohë dhe miqësore me investimet në spektrin radio 5G, për të nxitur lidhjen në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike nga kriza COVID-19 në Union”;

b) “Zyra kompetente *Broadband*” është sektori i zhvillimit *Broadband* (BCO), në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

Neni 3

Procesi për zhvillimin e praktikave të mira sipas *Toolbox*-it të BE-së

1. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë përmes njësisë “Zyra kompetente *Broadband*” (këtu e më poshtë “BCO”), në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sektorit publik, do të angazhohet për të zhvilluar praktikat e mira sipas *Toolbox*-it të BE-së, në lidhje me fushat e mbuluara në këtë udhëzim.

në kohë dhe miqësore me investimet në spektrin radio 5G, për të nxitur lidhjen në mbështetje të rimëkëmbjes ekonomike nga kriza COVID-19 në Union.



2. Kur është e nevojshme BCO do të bashkëpunojë me:

a) Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), si dhe përmes AKEP-it me Organin e Rregullatorëve Evropianë për Komunikimet Elektronike (BEREC);

b) Me autoritetet rregullatore për rrjetet e infrastrukturave të përcaktuara në nenin 7, të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

c) Rrjetin e zyrave kompetente *Broadband* të Bashkimit Evropian, si dhe autoritetet kompetente të ngarkuara me funksionet e pikës së vetme të informacionit, në lidhje me fushat e identifikuar në nenin 6, të këtij udhëzimi;

d) Grupin e Politikave të Spektrit të Radios (RSPG) dhe autoritetet rregullatore kombëtare kompetente respektivisht për fushat e identifikuar në lidhje me aspekte të koordinimit të frekuencave, sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

3. Deri më 30 qershor 2025, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) përmes BCO-së duhet të identifikojë dhe të ndajë me institucionet përkatëse praktikën më të mira në fushat e mbuluara nga ky udhëzim të prezantuar nga rrjeti i zyrave kompetente *Broadband* të Bashkimit Evropian.

4. Deri më 31 dhjetor 2025, BCO-ja, në bashkëpunim të ngushtë me institucionet e sektorit publik dhe autoritetet rregullatore të përcaktuara në pikën 2, të hartojë dhe propozojë një *Toolbox*, sipas praktikave më të mira të BE-së.

5. Për të garantuar transparencë dhe për të lehtësuar shkëmbimin e praktikave të mira ndërmjet institucioneve, BCO-ja do të përgatisë dhe do të bëjë publike në faqen e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, si dhe përmes pikave të vetme të informacionit informacionet e nevojshme për të gjitha palët e interesuara.

Neni 4

Rritja e koordinimit ndërinstitucional

Me qëllim rritjen e koordinimit ndërinstitucional dhe për të nxitur zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit, si dhe reduktimin e kostove në proceset e këtij zhvillimi, MIE, përmes BCO-së, do të ndërmarrë një proces analize dhe do

të propozojë masat e nevojshme jo më vonë se tre muaj nga hyrja në fuqi e këtij udhëzimi.

Neni 5

Përmirësimi i procedurave të dhënies së lejeve

1. Në zbatim të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit” dhe rregullave të miratuara me vendimit nr. 155, datë 11.3.2022, të Këshillit Ministrave, “Për miratimin e rregullave të përgjithshme për procedurat e dhënies të së drejtës së kalimit dhe ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë”, MIE, përmes BCO-së, do të ndërmarrë një proces analize për shkallën e zbatimit të këtij vendimi nga institucionet përgjegjëse, duke përfshirë identifikimin e praktikave të mira si dhe, ku është e nevojshme, përmirësimi i procedurave në përputhje me përcaktimet e rekomandimit të Komisionit (BE) 2020/1307.

2. Në procesin e analizës sipas pikës 1 të këtij neni, BCO-ja duhet të eksplorojë mundësitë bazuar në praktikën e mira të BE-së se, si:

a) respektohet afati maksimal ligjor për dhënien ose refuzimin e lejeve;

b) të thjeshtohet procesi i dhënies së lejeve, duke përfshirë ngritjen e procedurave të shpejta të dhënies së lejeve dhe/ose përjashtime nga leja kur është e përshtatshme, dhe përcaktimin e llojit të rrjeteve që do të vendosen që mund të përfitojnë nga këto;

c) mund t’u jepet operatorëve e drejta për të paraqitur, me mjete elektronike, nëpërmjet pikës së vetme të informacionit, aplikime për të gjitha lejet e nevojshme që kërkohen për punimet civile për vendosjen e elementeve të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë;

d) të rritet koordinimi me pikën e vetme të informacionit dhe institucionet përgjegjëse dhe si mund të lehtësohet shkëmbimi i informacion mbi ecurinë e këtyre procedurave ndërmjet aplikantëve dhe autoriteteve kompetente.

Neni 6

Përmirësimi i transparencës përmes pikës së vetme të informacionit

1. Bazuar në praktikën më të mira dhe të përshtatshme për të përmirësuar transparencën në



lidhje me infrastrukturën fizike, në mënyrë që operatorët të mund të aksesojnë më lehtë të gjithë informacionin përkatës mbi infrastrukturën e disponueshme në një zonë të caktuar të bashkëpunohet për forcimin e rolit të pikës së vetme të informacionit dhe zgjerimin funksioneve të tij që përfshijnë, për shembull, informacionin gjeoreferues dhe informacionin e integruar nga burime të ndryshme (në veçanti, informacioni i dhënë nga autoritetet kombëtare kompetente në çdo nivel, organet e sektorit publik dhe operatorët e rrjetit).

2. Ministria, përmes BCO-së, do t'u ofrojë institucioneve përgjegjëse praktikatat më të mira të BE-së dhe bashkëpunojë me to për zhvillimin e praktikave më të mira për të siguruar që informacioni i përmendur në nenin 8 të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, kur mbahet nga organet e sektorit publik, vihet në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit në format elektronik.

3. Përveç kësaj, duhet të konsiderohet vënia në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit në lidhje me infrastrukturën fizike përtej minimumit të përcaktuar në ligjin 120/2016, siç është vendndodhja gjeografike e infrastrukturës, modelit të saj digjital, llojit dhe përdorimit aktual të saj, ose kapacitetit të saj total dhe rezervë.

4. Për të përmirësuar më tej sasinë dhe llojin e informacionit të disponueshëm nëpërmjet pikës së vetme të informacionit, autoritetet përkatëse t'u kërkojnë operatorëve të rrjetit të vënë në dispozicion nëpërmjet pikës së vetme të informacionit dhe në formë elektronike formatin, informacionin në lidhje me infrastrukturën e tyre fizike ekzistuese, të cilën ata ia kanë vënë në dispozicion operatorëve të tjerë me kërkesë specifike.

5. Të vlerësohet se si mund të lehtësohen rregullimet në dispozicion të operatorëve për vendosjen e elementeve të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë, duke zhvilluar praktikatat më të mira për t'u mundësuar operatorëve të kenë akses në infrastruktura fizike (duke përfshirë ndërtesat dhe objektet e rrugës) e kontrolluar nga organet publike, e cila është në gjendje të hostojë/mbajë shumë elemente të rrjetit me kapacitet të lartë, në kushte të ngjashme me ato të përcaktuara në ligjin nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të

komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”.

Neni 7

Mekanizmat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve

Përveç sa parashikohet në nenin 7, të ligjit nr. 120/2016, “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, BCO-ja të ndajë me institucionet përgjegjëse informacion mbi praktikatat e mira të BE-së për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duke inkurajuar zhvillimin e praktikave më të mira që përmirësojnë efektivitetin dhe efikasitetin e mekanizmit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes në lidhje me aksesin në infrastrukturën fizike dhe funksionimin e organeve përgjegjëse për zgjidhjen e tyre, me synim për zgjidhjen e çështjeve të ndërlydhura brenda një afati sa më të shkurtër kohor dhe ofrimin e udhëzimeve palëve për kushtet dhe tarifat e duhura, duke përfshirë publikimin në kohë të vendimeve të tyre.

Neni 8

Reduktimi i efekteve mjedisore të rrjeteve

1. Zhvillimi i rrjeteve të shpejtësisë së lartë duhet të mbështetet dhe inkurajojë zhvillimin e praktikave më të mira për të nxitur vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me një ndikim të reduktuar në mjedis, veçanërisht në lidhje me përdorimin e energjisë dhe të lidhur me emetimet dhe gazrat, duke përfshirë:

a) kriteret për vlerësimin e qëndrueshmërisë mjedisore të rrjeteve të ardhshme;

b) stimujt e ofruar për operatorët për të vendosur rrjete të qëndrueshme për mjedisin.

Neni 9

Vlerësimi i ndikimit në mjedis

Në përputhje me legjislacionin në fuqi për vlerësimin strategjik mjedisor, për vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe për habitatet, kur kërkohet një vlerësim i ndikimit në mjedis, dhe në veçanti kur autoritetet përgatisin kuadrin për miratimin e projekteve të ardhshme për zhvillim, udhëzohet që të shkëmbehen praktikatat më të mira se si të performojnë dhe të marrin parasysh rezultatet të



vlërësimit mjedisor, në fazën kur mund të identifikohen dhe vlerësohen efektet mjedisore, si p.sh. kur operatorët paraqesin planet e përgjithshme për projektet që përfshijnë instalimin konkret ose vendosjen e rrjeteve.

Neni 10

Sigurimi i aksesit në kohë për spektrin dhe mjedisi miqësor për investimet

1. Në zbatim të parashikimeve në nenin 7 të ligjit nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, do të bashkëpunohet për përditësimin e politikës spektrale dhe planifikimin strategjik për frekuencat duke u mbështetur në praktikatat e mira të BE-së.

2. MIE do të bashkëpunojë me AKEP-in për të mundësuar sigurimin e aksesit në kohë të spektrit të frekuencave në brezat pionierë për zhvillimin e rrjeteve 5G që mundësojnë sigurimin e mbulimit dhe cilësinë e shërbimit sipas parashikimeve në ligjin nr. 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në përputhje me parashikime e ligjit për komunikimeve elektronike udhëzohet të bashkëpunohet me AKEP-in dhe autoritetet e tjera të BE-së për të shkëmbyer praktikatat më të mira në dhënien në përdorim të spektrit, si dhe në lidhje me stimujt për përdoruesit e spektrit të radios në shtrirjen e rrjeteve 5G, që janë zhvilluar ose zbatuar në vendet e Bashkimit Evropian. Në veçanti, do të analizohen dhe shikohen masat që vendet e BE-së kanë ndjekur sipas parashikimeve të seksionit IV, të Rekomandimit të Komisionit (BE) 2020/1307, në lidhje me:

a) promovimin e çmimeve të rezervës që pasqyrojnë nivelet optimale të tarifave për të drejtat e përdorimit të spektrit të radios;

b) praktikatat për shmangien e mungesës së spektrit dhe ato të harmonizimit në nivel Bashkimi Evropian;

c) duke siguruar në mënyrë jodiskriminuese mundësinë që tarifat për të drejtat e përdorimit të spektrit radio të paguhen në këste brenda periudhës së këtyre të drejtave;

d) duke përdorur një regjim autorizimi individual për brezin e frekuencës 24,25–27,5 GHz që

promovon përdorimin e tij në kohë duke përfshirë, në veçanti, atë që bazohet në procedura të shpejta administrative kur zbatohet në të drejtat e kufizuara të përdorimit gjeografikisht;

e) kombinimi i stimujve financiarë me detyrimet ose angazhimet formale për të përsheptuar ose për të zgjeruar cilësinë e lartë të mbulimit pa tel;

f) sigurimin, në varësi të ligjit të konkurrencës, të mundësisë për ndarjen e infrastrukturës pasive dhe aktive, si dhe për shtrirjen e përbashkët të infrastrukturës që mbështetet në përdorimin e spektrit të radios.

Neni 11

Rritja e koordinimit ndërkufitar të harmonizuar me praktikatat e BE-së

1. Në përputhje me praktikatat e BE-së për të promovuar praktikatat koherente për dhënien e të drejtave të përdorimit të spektrit radio tek operatorët për të vendosur infrastrukturën pa tel të gjeneratës së ardhshme (përfshirë 5G) për përdorim industrial ndërkufitar, sipas së cilës Shtetet Anëtare të BE-së duhet të zhvillojnë dhe bien dakord për praktikatat më të mira si pjesë e *Toolbox*-it, si dhe bazuar në parashikimin e pikës 3, të nenit 85 të ligjit 54/2024, “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, do të punohet, për:

a) identifikimin e rasteve të përdorimit në dimension ndërkufitar, veçanërisht për transportin rrugor, hekurudhor dhe prodhimin industrial, në përputhje me prioritetet e zhvillimit në harmoni me praktikatat e Bashkimit Evropian² në vendosjen e 5G që i shërbejnë plotësimi të reformës së agjendave dhe planit të ri të rritjes;

b) për çdo rast përdorimi të mundshëm të identifikuar, ose në identifikimin e një diapazoni të përbashkët të dedikuar frekuencash, në lidhje me regjimin përkatës të përbashkët të autorizimit, si dhe kushtet që i bashkëlidhen autorizimeve të tilla, të cilat janë të nevojshme për të siguruar vazhdimësinë e shërbimit përtej kufijve, duke përfshirë por pa u kufizuar në cilësinë e shërbimit dhe sigurisë së rrjetit.

2. Për zhvillimet e mësipërme udhëzohet të përdoren praktikatat më të mira të zhvilluara përmes *Toolbox*-it të BE-së, duke koordinuar me autoritetet përkatëse, si dhe RSPG-në, duke parë mundësitë e

² Shih në veçanti komunikimet e Komisionit COM(2016) 587 dhe COM(2020) 67.



realizimit të ofrimit të pandërprerë të shërbimeve të konektivitetit që lidhet me fushat e transportit rrugor, hekurudhor apo prodhimin industrial.

Neni 12
Raportimi

Njësia “Zyra kompetente *Broadband*” raporton çdo gjashtë muaj pranë ministrit përgjegjës për zbatimin e masave të përcaktuara në këtë udhëzim.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR DHE
MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku

URDHËR
Nr. 1131, datë 27.12.2024

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
MURTAJËS AFRIKANE TË DERRAVE
NË KAFSHËT E GJALLA TË LLOJIT
DERRA TË BUTË, NË MJEDISËT E
HAPURA DHE NË TREGJET E
KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën “b” të nenit 15 dhe në nenin 21 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; në urdhrin nr. 241, datë 30.7.2012, “Për miratimin e rregullores mbi kontrollin e sëmundjes së murtajës afrikane të derrave”; në planin e kontigjencës nr. 10390/1 prot., datë 24.11.2020, “Për sëmundjen e murtajës afrikane të derrave”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e tregtimit të derrave të gjallë në mjediset e hapura dhe tregjet e kafshëve të gjalla, në territorin e Bashkisë Lezhë.

2. Ndalimin në territorin e Bashkisë Lezhë të lëvizjes së derrave të gjallë nga ferma në fermë, dhe nga ferma në tregje, panairë dhe ekspozitat e kafshëve të gjalla.

3. Veterineri zyrtar mund të autorizojë me miratim të titullarit të Drejtorisë Rajonale të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, lëvizjen e derrave për mbarëshitim, vetëm nga fermat pa prezencë të sëmundjes që ndodhen në zonën e mbrojtjes, për në thertoren më të afërt brenda zonës së mbrojtur ose në zonën e mbikëqyrur kur nuk është e mundur që kafshët të theren në zonën e mbrojtur.

4. Të kryhet inventarizimi dhe gjurmimi me teste laboratorike konfirmatore për sëmundjen e Murtajës Afrikane të Derrave në zonat e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes, në njësitë administrative: Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll të Bashkisë Lezhë.

5. Të forcohet marrja e masave për kontrollin e lëvizjes së kafshëve, zbatimin e masave të biosigurisë dhe masave sanitaro-veterinare në zonën e mbrojtjes dhe mbikëqyrjes në Njësitë Administrative Shëngjin, Kolsh, Zejmen, Lezhë, Balldre, Kallmet dhe Shënkoll.

6. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj

URDHËR
Nr. 1132, datë 28.12.2024

**PËR MARRJEN E MASAVE KUFIZUESE
PËR PARANDALIMIN DHE
KONTROLLIN E SËMUNDJES SË
INFLUENCËS AVIARE NË SHPENDË,
NË MJEDISËT E HAPURA DHE NË
TREGJET E KAFSHËVE TË GJALLA**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës; në shkronjën “b” të nenit 15 të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën

Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë

